



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.435/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Fejzullah Rexhepi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e Xhafer Berisha, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Ferizajt, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të pa rregullta ankesat e Xhafer Berisha, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Ferizajt, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me shenjen ZL.Anr.435/2017 dhe ZL.A.nr.436/2017 të datës 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017,

A r s y e t i m

Më datën 23.10.2017, PZAP-i, ka pranuar dy ankesa nga Xhafer Berisha, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Ferizajt, nga radhët e subjektit politik NISMA, me të cilat kërkon që të rinumërohen votat në Komogllavë, në vendvotimet: 2510D/01R, 2510D/02R, 2010D/03R, 2510D/04R, 2510D/05D, dhe në Varosh, në vendvotimet: 2509D/01R, 2509D/02R, 2509D/03D.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.435/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankesës gjeti se:

Ankesat janë të pa rregullta

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesat e parashtruara nga ana e Xhafer Berisha, janë të parregullta sepse nuk janë nënshkruar nga Xhafer Berisha dhe si të tilla ankesat nuk i plotësojnë kushtet siç kërkohen me nenin 5.6 të Rregullës nr.02/2015, të PZAP-it dhe në bazë të nenit 118 të LZP-së ku përcaktohet se: *Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.*

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbështetj të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.435/2017 më datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Zyhdi Haxhiiri



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.